Kronikë

Berat/ Policia kontrolle në qytet për goditjen e veprimtarive kriminale dhe personave në kërkim! 2 të arrestuar

Policia e Beratit ka kryer kontrolle intensive në këtë qytet për goditjen e veprimtarive kriminale dhe personave të shpallur në kërkim. Gjatë kontrollit të kryer njërit nga të arrestuarit iu gjet doza kanabisi, armë gjahu dhe armë të ftohta. Ndërkohë personi tjetër dyshohet se ka vjedhur një makinë në Kuçovë në vitin 2021.

Arma e gjahut, thika dhe kanabis i sekuestruar

[Sh.com] Redaksia
4 Prill, 09:17 | **Përditesimi: 4 Prill, 09:22**

Share

Berat-Policia e Beratit ka kryer kontrolle intensive në këtë qytet për goditjen e veprimtarive kriminale dhe personave të shpallur në kërkim.

Sipas njoftimit për mediat policia bën me dije se ka arrestuar 2 persona.

Gjatë kontrollit të kryer njërit nga të arrestuarit iu gjet doza kanabisi, armë gjahu dhe armë të ftohta. Ndërkohë personi tjetër u ndalua nga blutë pasi dyshohet se ka vjedhur një makinë në Kuçovë në vitin 2021.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
'Rrugët me gropa, kalojmë me mushka', banorët e fshatrave protestojnë në Berat dhe Maliq

> *"Specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve të DVP Berat arrestuan shtetasin S. D., 40 vjeç, sepse gjatë kontrollit fizik, iu gjet një sasi lënde narkotike Cannabis Sativa, e ndarë në doza, me qëllim shitjen, si dhe 1 armë gjahu, 1 armë e ftohtë (thikë) dhe municion luftarak, që u sekuestruan me cilësinë e provës materiale;*
>
> *Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Kuçovë kapën dhe vunë në pranga shtetasin e shpallur në kërkim, K. O., 40 vjeç, banues në Kamzë. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat i ka caktuar këtij shtetasi, masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprën penale "Vjedhja", sepse dyshohet se në vitin 2021, ka vjedhur një automjet, në Kuçovë", thuhet në njoftimin e policisë.*

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë Berat, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: arme gjahu | kanabis | vjedhje | Berat

Komento

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

[Sh.com]

Sondazhi i ditës: 3 Prill, 11:51
Trump tarifa doganore 10 për qind Shqipërisë, sa ndikon në ekonomi?

Shumë | Pak | Nuk e di

Lajme të tjera

Me puset e naftës në oborret e shtëpive, banorët e Kuçovës: Rrezik për jetën! 'Albpetrol': Do rrethojmë puset në zonën urbane

Mimoza Sinanaj

3 Prill, 15:30

Momenti kur hajdutët thyejnë derën e biznesit dhe hyjnë brenda/ Zbardhen pamjet, në pranga 4 anëtarë të grupit kriminal në Fushë Krujë

2 Prill, 13:42

Fillimisht u tha se i dorëzuan, por kamerat e sigurisë 'kapin mat' çiftin irlandez, dyshohet se vodhën 41 mijë euro në Durrës

Aldo Mustafa

1 Prill, 18:49

Kuçovë/ U rrëzua nga shtylla elektrike teksa po punonte, elektriçisti dërgohet në spital

1 Prill, 16:17

Arrestohet i riu zvicerian në Tiranë, i vodhi me dhunë një 52-vjeçari celularin (VIDEO)

31 Mars, 14:49

Çmontohet grupi kriminal i shqiptarëve në Spanjë/ Arrestohen disa persona, gjendet lëndë narkotike me vlerë prej 482.500 euro

31 Mars, 12:55

Hajdutëve në Lushnjë u dështon plani/ Tentojnë të vjedhin një biznes, por përfundojnë në kanal! Ikin pa kasafortën me para (VIDEO)

31 Mars, 09:54

Autor të disa vjedhjeve, arrestohen 2 skifterët në Vlorë

28 Mars, 12:01

Banorët e Zogasit në Skrapar në protestë kundër gurores: Na shkatërron tokat bujqësore! Kryeplaku: Kompania e Myslim Murrizit

27 Mars, 17:34

Vlorë/ Vodhën tre banesa dhe një automjet në fshatin Fitore, 1 i arrestuar dhe 2 të tjerë në kërkim (EMRAT)

27 Mars, 09:21

Berat/ Përplasi këmbësoren dhe u largua, nis hetimi për 60-vjeçarin

26 Mars, 11:07

Aksident në aksin Berat-Duhanas, mjeti del nga rruga, shpëton shoferi, nxirret me ndihmën e forcave zjarrfikëse

25 Mars, 20:39

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje